



Република Македонија
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ
Republika e Maqedonisë
AVOKATI I POPULLIT
Republic of Macedonia
O M B U D S M A N

**AVOKATI I POPULLIT
I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
MEKANIZMI PARANDALUES NACIONAL**

**PROGRAMI VJETOR I
MEKANIZMIT PARANDALUES NACIONAL
PËR VITIN 2013**

Shkup, janar 2013

**PROGRAMI VJETOR I
MEKANIZMIT PARANDALUES NACIONAL**

PËR VITIN 2013¹

Korniza kohore: prej muajit janar-dhjetor të vitit 2013

Realizues: këshilltarë të Seksionit për parandalimin e torturës dhe llojeve të tjera të trajtimit brutal, jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues, bashkëpunëtorë të jashtëm dhe OJQ-të

AKTIVITETE:

RAPORTI VJETOR PËR VITIN 2013 (korniza kohore: prej muajit janar-maj të vitit 2013)

1. Hartim i raportit vjetor për vitin 2012 (janar-mars 2013)
2. Promovimi i raportit vjetor për vitin 2012 (prill-maj 2013)

Është hartuar raporti, shtypur në tre gjuhë - është mbajtur pres-konferencë më datë 16 maj të vitit 2013

Është dërguar pranë të gjitha ministrive kompetente, pranë Qeverisë, pranë kryetarit të Kuvendit të RM-së, vendeve të privimit nga liria, gjyqtarëve për ekzekutimin e sanksioneve, shoqatave të qytetarëve, bashkëpunëtorëve të jashtëm.

Është dërguar pranë SPT,CPT,APT, Këshillit të Evropës, ambasadave, OKB-së

VIZITA TË RREGULLTA PARANDALUESE DHE HARTIMI I RAPORTEVE TË VEÇANTA (korniza kohore: prej muajit shkurt-dhjetor të vitit 2012)

Gjithsej numri i vizitave të rregullta parandaluese – 19 - të realizuara 16 vizita

¹ Konform rekomandimit të Nënkomitetit për parandalimin e torturës, Seksioni për parandalimin e torturës harton programin e veçantë dhe planin për punë: "The NPM establish a work plan/programme wich, over time, encompasses visits to all, or any, suspected, places of deprivation of liberty, as set out in Articles 4 and 29 of the Optional Protocol, which are within the jurisdiction of the State."CAT/OP/12/5: Guidelines on national preventive mechanisms, 05 Dec 2010, point 33)

1. Stacione policore: **10 vizita** (kompetenc e përgjithshme dhe 3 polici kufitare)

9 (6 stacione policore dhe 3 vendkalime kufitare)

2. Institucione ndëshkuese-korrektuese: **1 vizitë (Sektori për arrestim), 2 – Reparti i hapur në Kriva Pallankë dhe Reparti për arrest**

3. Ente për pleq: **4 vizita – anuluar për vitin 2014**

4. Institucione psikiatrike: **1 vizitë (Klinika për psikiatri)– 1 vizitë në Klinikën psikiatrike**

5. Vende tjera të privimit nga liria: **3 vizita** (IP Enti për rehabilitimin e fëmijëve dhe të rinjve „Topansko pole”, IP Enti për mbrojtje dhe rehabilitim–Banja Bansko, Shtëpi për fëmijë pa prindër „11 Tetori”, Shkup)- **4 vizita (IP Enti për rehabilitim të fëmijëve dhe të rinjve „Topansko Pole”, IP Enti për mbrojtje dhe rehabilitim –Banja Bansko, Shtëpi për fëmijë pa prindër „11Tetori”- Shkup dhe Drejtoria doganore)**

VIZITA PASUESE DHE HARTIMI I RAPORTEVE–Fokusi në vëzhgimin e implementimit të rekomandimeve të dhëna (korniza kohore: prej muajit janar–dhjetor të vitit 2013)

Gjithsej numri i vizitave pasuese-**12 –të realizuara 16 vizita pasuese**

1. Stacione policore - **5 vizita - 4 vizita**
2. Institucione ndëshkuese-korrektuese -**3 vizita - 6 vizita (5 burgje dhe 1 Ent edukativo-korrektues)**
3. Qendra për të huaj - **1 vizitë - 1 vizitë**
4. Qendra për azilantë - **1 vizitë - 1 vizitë**
5. IP „Ranka Millanoviq” Shkup-**3 vizita - 2 vizita në Institucion publik për përkujdesjen e fëmijëve me probleme edukativo-sociale (përfshirë vizitë nate në IP „25 Maj”)**
6. Spitali psikiatrik - **1 vizitë - nuk ka**
7. **1 vizitë në Entin special për persona me pengesa mendore - Demir Kapi**
8. Në mënyrë plotësuese: **Vizitë e jashtëzakonshme në Sektorin për paraburgim në Burgun-Ohër.**

INICIATIVA PËR NDRYSHIME TË AKTEVE LIGJORE DHE NËNLIGJORE

1. Iniciativa për ndryshime të Ligjit për zbatimin e sanksioneve dhe akteve përkatëse nënligjore (korniza kohore: janar-mars 2013)

2. Iniciativa për ndryshime të dispozitave ligjore dhe nënligjore lidhur me shëndetin mendor dhe ndalje dhe përkujdesje në institucionet psikiatrike (korniza kohore: tetor-dhjetor 2013)

Të transferuara për vitin 2014 për shkak të rritjes së volumit të punës me vizita parandaluese dhe punëtori edukative.

Iniciativë e dërguar për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurë penale

AKTIVITETE PROMOVUESE-EDUKATIVE (korniza kohore: prej muajit mars-dhjetor të vitit 2013)

1. Tre tryeza të rrumbullakëta (grupet e synuara: gjykatës dhe policia) **TAIEX-punëtorja (3) për video mbikëqyrje, roli i gjykatësit mbi mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria dhe të miturve në procedurë policore, një Konferencë rajonale në Shkup me MPN-në rajonale (MPN-rrjeti i Ballkanit), udhëtim studimor dhe vizitë e MPN-së në Danimarkë.**

2. Takime me udhëheqës të institucioneve dhe organeve përkatëse (Ministria për drejtësi, Policia financiare, Policia kufitare etj.)

3. Promovimi publik i MPN-së vazhdimisht gjatë vitit (informata në Ueb-faqen, komunikata për media, pres-konferenca dhe ngj.) **në Ueb-faqen edhe komunikata për Ditën ndërkombëtare për mbrojtjen e viktimave nga tortura 26 Qershor.**

4. Prezantimi i raportit vjetor të MPN-së pranë shoqërisë civile - **Prezantimi i raportit me rastin e 10 Dhjetorit pranë studentëve të Fakultetit për siguri,**

Trajnime për studentë në Qendrën për trajnime të MPB-së

Ligjerata në Qendrën e MPB-së për njësitë speciale „Alfa” dhe njësitë intervenuese.

PËRFORCIMI I KAPACITETEVE TË SEKSIONIT

1.Pjesëmarrje në konferenca dhe seminare-sipas nevojës dhe sipas ftesës

Pjesë e Rrjetit të MPN-së të Ballkanit, pjesëmarrje në konferencat e rrjetit, takim i grupit medicinal të Rrjetit të MPN-së të Ballkanit së bashku me bashkëpunëtorin e jashtëm-psikiatër.

Pjesëmarrje në Tryezën e rrumbullakët në Qendrën për iniciativa civile-Kthim në bashkësinë për ri-integrim më të mirë.

Në organizim të Këshillit të Evropës dhe Mekanizmit Parandalues Nacional (MPN-së) të Mbretërisë së Bashkuar, më datë 21 dhe 22 nëntor në Strazbur, Francë, u mbajt Konferenca me temë „ Ndalja e migrantëve në Evropë-Themelimi i përbjekjeve të përbashkëta dhe zhvillimi i standardeve minimale”.

PARAKUSHTE MATERIALE-NJERËZORE PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT:

1. Punësim i 1 këshilltari për parandalimin e torturës në MPN (rritja e efikasitetit të MPN-së përmes ndarjes së punës në dy ekipe, secili ekip i përbërë nga dy këshilltarë)
2. Angazhim i profileve profesionale-(psikiatër, infermiere dhe defektolog)
3. Angazhimi i OJQ-ve gjatë vizitave pasuese në stacionet policore
- 4.Veturë për realizimin e e vizitave të rregullta dhe pasuese preventive

Memorandum i kontraktuar për bashkëpunim me 7 asociacione profesionale ku janë inkuadruar profilet në vijim: psikiatër, punëtorë social, psikologë, forenzistë, defektologë, kriminologë dhe juristë të Shoqatës së juristëve të rinj.

**AVOKATI I POPULLIT
Ixhet Memeti**

